

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriqiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit A. H., nga Komuna e Podujevës, për shkak të një veprë penale në vazhdim vjedhje pylli nga neni 258 par.2 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr. 479/16 dt. 24.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2016, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit A. H. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.479/2016 datë 24.05.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë PKA.nr.43/2012 datë 14.03.2016, i dënuari A. H. është shpallur fajtor për një veprë penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 258 par.2 të KPK, dhe për këtë veprë penale iu është shqiptuar dënimi i kushtëzuar duke i përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë penale si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 400 €, (katërqind euro), të cilin është i detyruar ta paguajë në

afat prej 15 ditësh e në rast mos pagese e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim burgu ku për çdo 20 €, të filluar do t'i llogaritet për 1 (një) ditë burgimi. Është liruar nga shpenzimet e procedurës penale si dhe shuma e paushallit. E dëmtuara Agjencioni Pyjor i Kosovës, Zyra në Podujevë për realizimin e kërkesës pasuroro juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.479/2016 datë 24.05.2016, mënyrën sa vijon:

“I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë P.nr.43/2012 datë 14.03.2016, përkitazi me vendimin për dënimin me kusht, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarin A. H., për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim , nga neni 358 par.2 të KPK, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II.Në pjesët tjera aktgjykimi ngel i pandryshuar”.

Kundër këtyre aktgjykimeve i dënuari A. H. ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë të ndryshohet ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.126/2016 datë 30.06.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë , gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar për mbrojtje të ligjshmërisë i dënuari thekson se gjykata e shkallës së dytë edhe përkundër faktit se në anën e të dënuarit kanë ekzistuar një mori rrethanash lehtësuese, meqenëse është i gjendjes së varfër ekonomike, mbajtës i familjes , përfitues i

ndihmës sociale, ndërsa së fundi i shpallur veteran i UQK-së, edhe përkundër këtyre rrethanave lehtësuese ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë duke i shqiptuar dënim burgu efektiv dhe dënimin me gjobë, ndërsa të dënuarin nuk e njofton për seancën e kolegjit të mbajtur pranë gjykatës së shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme , pretendimet e mësipërme të theksuara në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk qëndrojnë për faktin se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 14.03.2016, vërtetohet se i dënuari është udhëzuar në mënyrë taksative mbi të drejtat e tija në procedurë dhe se me këtë rast i dënuari deklarohet se jo vetëm që i ka kuptuar të drejtat e tija në procedurë , por e ka kuptuar edhe akuzën, ku më pastaj i dënuari deklaron se i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës si dhe favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë i cili në mënyrë decidive deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim për të cilën është akuzuar, ndërsa gjykata konstaton se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit është bërë në mënyrë vullnetare me ç'rast merr vendimin mbi pranimin e fajësisë.

Qëndron fakti se kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit për dënimin , ndërsa i dënuari ka paraqitur përgjigjen në ankesën e Prokurorit, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me të drejtë seancën e kolegjit e mban konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, pa i njoftuar palët në procedurë, për faktin se gjykata e shkallës së dytë njoftimin palëve në procedurë u dërgon vetëm për veprat penale për të cilat iu është shqiptuar dënimi me burgim efektiv nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa konform dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi gjer më 01.01.2013, njoftimin për seancën e kolegjit e bënë vetëm me kërkesën e palëve në procedurë, andaj pretendimet e theksuara në kërkesë janë të pabazuara.

Po ashtu pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me shkelje të ligjit penal siç theksohet në kërkesë të të dënuarit se është pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të paqarta për faktin se shkeljet e ligjit penal për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të parashikuara me dispozitën e nenit 385 të KPPK, i cili në mënyrë taksative parasheh rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është i përfshirë me këto shkelje, ndërsa në kërkesë nuk precizohet se për cilat shkelje bëhet fjalë.

Vlen të theksohet se gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin, me ç'rast rrethanat lehtësuese të konstatuara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të theksuara edhe në kërkesë i ka pasur parasysh, mirëpo duke i pasur parasysh rrethanat rënduese se brenda një periudhe kohore mjaft të shkurtë ka prerë drunj (trungje) në një sasi mjaft të madhe, vendosmërinë e të dënuarit në kryerjen e veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim janë vërtetë rrethana rënduese që kanë ndikuar në ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Nga arsyet e cekura më lart e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.173/2016 datë 05.09.2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa